



Universiteti Bujqësor i Tiranës Fakulteti i Mjekësisë Veterinare

Zhvillimi dhe konsolidimi i kapaciteteve edukative dhe kërkimore të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe njeriut nga sëmundjet zoonotike dhe me ndikim të rëndësishëm ekonomik nëpërmjet përdorimit të metodave moderne laboratorike dhe transferimit të teknologjive inovative

Përgatitën

Prof. Dr. Dhimitër Rapti
Prof. Asoc. Rezart Postoli
Prof. Asoc. Xhelil KOLECI



Objektivat e Përgjithshme

- Studimi i pranisë, shkallës së përhapjes dhe ndikimi ekonomik i sëmundjeve: paratuberkuloz, rinotrakeitit infektiv (IBR), Diareasë Virale (BVD) dhe Neosporozë në gjedhë;
- Studimi i pranisë dhe shkallës së përhapjes së Ekinokozës, Leishmaniozës dhe Dirofilariozës në qen;
- Përpilimi i programeve specifike të kontrollit për sëmundjet paratuberkuloz, IBR, BVD në gjedhë;
- Krijimi i një qendre mbështetëse profesionale dhe sigurimi i lehtësirave kualifikuese për grupet e interesit (mjekëve veterinarë, fermerëve, pronarëve të kafshëve të vogla dhe klinikave veterinare)

Plani i përgjithshëm i punës së projektit

- Studimi i fisibilitetit të projektit. Përcaktimi i madhësisë së kampioneve, identifikimi i qarqeve, fshatrave, fermave dhe përzgjedhja e individëve duke përdorur modele epidemiologjike;
- Grumbullimi dhe testimi i kampioneve duke aplikuar metoda bashkëkohore diagnostike (teknika molekulare dhe imunologjike) për identifikimin e shkaktarëve të sëmundjeve infektive dhe zoonotike në kafshët e shoqërimit dhe prodhimit;
- Përpunimi statistikor i rezultateve të fituara, analiza ekonomike e sëmundjeve paratuberkuloz, BVD, IBR;
- Hartimi i strategjive dhe masave të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve infektive në kafshët e prodhimit bazuar në risk

Sëmundjet e përfshira

Në qen

- Ekinokokoza
- *Dirofilarioza*
- Leishmanioza

Në gjedhë


- Paratuberkulozi
- Diarrea virale e gjedhit
- Rinotrakeiti infektiv i gjedhit
- Neosporoza

Justifikimi teknik i projektit

Pse janë përfshirë këto sëmundje?

1. Në total **57.14%** e sëmundjeve të përfshira në studim potencialisht janë zoonoza
2. Sëmundjet e kafshëve të fermës janë:
 - a) Sëmundje me ndikim më të madh ekonomik;
 - b) Nuk janë pjesë e programeve kombëtare të kontrollit (nuk ka dublim studimesh);
 - c) Kërkojnë teknika të sofistikuar diagnostike- tipit kërkimor;
 - d) Kanë lidhje sinergjike epidemiologjike me njëra tjetrën, në disa raste shkaktojnë konfuzion në diagnostikimin e tyre;
 - e) Në vendin tonë nuk ekziston asnjë program kontrolli, ndërsa në vendet e zhvilluara të botës përparimet janë të mëdha dhe ato janë treguar efikase dhe ekonomikisht të justifikueshme

Chi J et al (2002) Preventive Veterinary Medicine Journal



Perceptimi klinik i problemit

Problemi aktual i tufës



Iceberg



Klinikisht e prekur



Klinikisht e prekur



Problematika që studimi synonte të zgjidhte

A janë prezente këto sëmundje ?

Sa është frekuenca e tyre ?

Cila është/janë metoda/t e Kontrollit?


Impakti ekonomik i sëmundjeve paratuberkuloz,
IBR dhe BVD.

A është favorizues raporti Kosto-Përfitim i
programit/ve të kontrollit?

Përpilimi i programeve/protokolleve monitoruese
dhe kontrolluese

Aktivitet e kryera

Studimi i fisibilitetit, Blerja e materialeve, Grumbullimi i kampioneve të serumeve nga kafshët të ndryshme



Detyra të kryera

Identifikimi i fermave të kafshëve në vendet ku do të kryhet studimi

U përlogaritën numri i nevojshëm i fermave dhe kampioneve

$$n = 4 \times P \times Q / d^2$$

U identifikuan klinikat veterinare

Stadi i parë	
Numri i fermave që u kampionuan	
z	1.96
p	0.3
1-p	0.7
d	0.07
n	143.64

Shtrirja e studimit

Në projekt janë përfshirë direkt


- 144 ferma gjedhi (>10 krerë)
- 16 klinika veterinare




Aktivitetet (Vazhdim)

- U prelevuan 4500 kampione serumi gjedhi. Ekzaminimi i 600 qenve dhe kryerja e nekropsive të 120 qenve bashkë me të dhënat e hollësishme mbi rajonin, fermën, moshën, emrin, seksin, pronarin dhe specien
- U analizuan 2407 kampione për sëmundjen Paratuberkuloz, 1380 kampione për sëmundjen BVD, 1380 kampione për sëmundjen IBR dhe 720 kampione për sëmundjen e shkaktuar nga *Neospora caninum* me qëllim vlerësimin e prevalencës së infeksionit për shkaktarët e marrë në studim në Shqipëri;
- Rritja dhe zhvillimi i kapacitetit të Laboratorit të Sëmundjeve Infektive në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare nëpërmjet sigurimit të aparaturave më moderne dhe mjeteve kryesore të diagnostikimit (kite dhe primera) për identifikimin e shkaktarëve të sëmundjeve infektive;
- U krye analiza ekonomike mbi bazën e prevalencës së sëmundjeve BVD, IBR dhe Paraturbekuloz dhe vlerësimi i raporteve kosto/përfitim për programet e kontrollit;
- Aplikimi i praktikave tërësore të biosigurisë në fermat blektorale për kontrollin e BVD-së, IBR-së dhe Paraturbekulozit;

Rezultatet



Rezultatet



Rezultatet

Sëmundja	Prevalenca	
	Midis tufave %	Brenda tufave %
Paratuberkuloz	0-37.5	6.7-20.4
BVD	37.5-76.19	7.14-47
IBR	33.33-85.71	44.28-91.36

Rezultatet (vazhdim)

- Nga viti 2011 deri 2012, u realizua nekropsia e 120 qenve nga disa zona periferike rreth Tiranës dhe trakti gastrointestinal u ekzaminua për praninë e helminteve në zorrë. Nga mostrat fekale të qenve të ekzaminuar janë identifikuar 12 raste pozitive me *E. granulosus* (10%)
- Përqindje më e lartë rezultoi tek qentë pa pronarë
- Analiza molekulare (PCR) të *E. granulosus* tregoi se kishin homologji 100% me shtamin e zakonshëm në dhen G1;
- Në 6 raste u identifikua prezenca e *D. immitis* në ventrikulin e djathtë të zemrës në ndërkohë që analizat serologjike tek qentë në Shqipëri rezultojnë se variojnë nga 3% në 13.5%.

Rezultate

- Janë publikuar 5 artikuj, 5 pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, janë mbrojtur 2 teza master, 3 tema diplomash studentësh;
- Është krijuar baza reale infrastrukturore për bashkëpunim me kolegët brenda dhe jashtë vendit
- Realizimi i praktikave tërësore të biosigurisë në fermat blektorale për kontrollin e BVD-së, IBR-së dhe Paraturbekulozit;
- Janë hartuar dhe janë gati për publikim e për tu ndarë me grupet e interesit programe bashkëkohore dhe të përballueshme për kontrollin e sëmundjeve MAP, BVD, IBR dhe për të kryer monitorimin e *Neospora caninum*;

Përfundime

- Sëmundjet paratuberkuloz, BVD, IBR, neosporozë, ekinokozë, dirofilariozë, leishmaniozë janë të pranishme dhe qarkullojnë në kafshët e fermës dhe ato të shoqërimin dhe kërcënojnë seriozisht shëndetin e kafshëve dhe njeriut;
- Analiza ekonomike tregon se sëmundjet MAP, BVD, IBR kanë impakt të rëndësishëm në fermat e gjedhit;
- Analiza ekonomike kosto/përfitim bazuar në nivelet aktuale të prevalencave respektive, tregon se kontrolli i sëmundjeve paratuberkuloz, BVD, IBR është një sipërmarrje efektive dhe me interes;

Përfundime

Sëmundja	Prevalenca		Humbjet ekonomike direkte	Kostoja e programit	Përfitimi
	Midis tufave %	Brenda tufave %			
	Mesatarja lekë /lopë/vit				
Paratuber kuloz	0-37.5	6.7-20.4	7500	3350	4150
BVD	37.5-76.19	7.14-47	7850	3875	3975
IBR	33.33-85.71	44.28-91.36	2200	700	1500

Përfundime

- Infrastruktura e laboratorit të sëmundjeve infektive është rritur dukshëm dhe tashmë ai ka kapacitete dhe mundësi për diagnostikimin e sëmundjeve infektive enzootike, emergjente dhe ri-emergjente;
- Mundësohet shërbimi për të tretët
- Rezultatet e studimit shërbejnë për krijimin e një baze të dhënash për hartimin e programeve kombëtare për kontrollin e sëmundjeve specifike në vendit tonë;
- Rezultatet e studimit hapin perspektiva të reja për ndërmarjen e studimeve të thelluara shkencore, transferimin e teknologjive dhe aplikimin e metodave bashkëkohore në kontrollin me sukses të sëmundjeve me rëndësi ekonomike ose zoonotike

Rëndësia e studimit

- Studimi siguroi
 - Të dhëna epidemiologjike mbi frekuencën e sëmundjeve në studim
 - Informacion profesionalo-shkencor, mundësi shërbimi diagnostik, konsultative, trainimi, këshillimi, ekspertize
- Kryerjen e studimeve nga PhD studentë, master shkencor dhe profesional
- Aplikimi i teknikave molekulare (inovative) për diagnostikimin në kohë dhe me saktësi të sëmundjeve
- Modelim epidemiologjik të sëmundjeve të marra në studim (inovative)
- Mbështetje teknike dhe shkencore për hartimin e programeve për kontrollin dhe erradikimin e sëmundjeve, plane të detajuara të biosigurisë dhe parandalimit të tyre (inovative)
- Informacion për publikun mbi rrezikun zoonotik dhe metodat më efikase të kontrollit të zoonozave të studiuara
- Kryerjen e analizës kosto-përfitim (CBA) të programeve të kontrollit (inovative)
- Publikimin dhe prezantimin e rezultateve në revista e aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare

Perspektiva e Projektit në të Ardhmen

Bazuar në njohuritë më të mira të autorëve, është e nevojshme

1. Mbështetja e programeve kërkimore specifike e ndërdisiplinare me qëllim gjenerimin e të dhënave mbi frekuencën e sëmundjeve më të rëndësishme për kafshët e fermës dhe ato të shoqërimit ku mund të bazohen prioritetet e shërbimit veterinar shqiptar dhe të hartohen programet e përditësuara për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve me rëndësi veterinare dhe zoonotike;
2. Mbështetja e mëtejshme infrastrukurore për aplikimin të sistemeve të avancuara kërkimore dhe diagnostike (MINI PCR AMPLYUS LLC, Biolog etj)
3. Natyra komplekse dhe kronike e sëmundjeve MAP, BVD, IBR, kostoja e lartë e masave të kontrollit dhe çrrënjosjes dhe periudha e gjatë (10-15 vite) janë sfida të vështira por të realizueshme. Ndaj është e domosdoshme që mbështetja dhe programi të vazhdojë, por kërkohet harmonizim me programe të tjera dhe pëfshirjen e të gjithë aktorëve të interesit, fermer - shërbim veterinar- institucione kërkimore (kostoja e lartë mund dhe duhet të mbështeten nga programe subvencionues).



FALEMINDERIT